

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Nr. i Prot. 2312-2/25
 Prot. No. 20.05.25
 Data: 20.05.25
 Nr. i Faqeve 04
 Nr. i Stranica 04
 No. 1

SP-02
 04
 PRISHTINË / A



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
 Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	14.05.2025
REFERENC-Ë:	25/2312/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Joos Krasniqi Limited Construction" Sh.p.k. Meje, Gjakovë. Ekspluatim i gurit gëlqeror, Shkoza, Komuna Junik.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Joos Krasniqi Limited Construction" Sh.p.k. Meje, Gjakovë, me nr. prot. 25/2312/MMPHI me veprimtarinë: Ekspluatim i gurit gëlqeror, Shkoza, Komuna Junik.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/2312/MMPHI
Datë: 14.05.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "Joos Krasniqi Limited Construction" Sh.p.k. Meje, Gjakovë me nr. prot. 25/2312/MMPHI, i refuzohet kërkesa për tu pajisur me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, Shkoza ,Komuna Junik, në ngastrat nr. 336, nr. 338/1 dhe nr.338/2, zona kadastrale Junik.

A r s y e t i m

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);

- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 09/1071/1-ZSP-425/09 , të lëshuar me dt. 02.11.09.2009.

MMPHI, konstatoi se operatori nuk i plotëson kriteret e parapara për pajisje me Leje Mjedisore, pasi qe ka gjetur si në vijim:

- Licenca e Shfrytëzimit nga KPMM, me nr. 2072/KPMM/2020, iu është pezulluar, me datë: 15.03.2022;
- Leja Mjedisore e shfuqizuar pjesërisht , me nr.16/644/ZSP/232/16, lëshuar me datë: 24.12.2016.

Bazuar në faktet e cekura më lartë dhe për shkakun që kompania që merret me shfrytëzimin dhe eksploatimin e gurit gëlqeror, gjendet në brendi të territorit të Parku Kombëtar, "Bjeshkët e Nemuna", andaj Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, paraprakisht ka refuzuar operatorit Lejen Mjedisore, me datë:

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, refuzon kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore, në përputhje me nenin 12 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Junik;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.